

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE PËR AKTIVITETIN:

“Perzierja dhe hollimi I produkteve te pastrimit dhe te trajtimit te ujit te pijshem”

Vendodhja: Rruga “Ura Beshirit”, fshati Lalm, Njesia Administrative Vaqarr, Bashkia Tirane.

Kërkues: Subjekti: “CHEMICA D’AGOSTINO S.P.A.” dshh

Janar, 2021

1 TË PERGJITHSHME

Subjekti juridik "CHEMICA D'AGOSTINO S.P.A." dshh me administrator Z. Leonardo Volpicella, është regjistruar në QKB me NUIS, L21409008V për ushtrimin e veprimtarisë në fusha të ndryshme ku përfshihet edhe:

Prodhim, përpunim dhe tregtim të produkteve kimike në përgjithësi dhe dytesore që kanë përdorim të ndryshëm si industriale, ekologjike, farmaceutike, kozmetike dhe shtëpiake, detergjent, detergjive dhe produkte higjene; produkte për trajtimin e ujërave; produkte për trajtimin dhe riciklimin e mbetjeve urbane dhe/ose industriale dhe toksike; prodhim dhe/ose të materialeve plastike dhe derivate; drejtim, mirëmbajtje, kontroll, nëpërmjet menaxhimit të duhur të impianteve të ujërave të pishëm me paradisinfektim, aglomerizim, filtrim i shpëtojë dhe postdezinfektim i ujërave sipërfaqësore të lumenjeve, liqeneve dhe të ngjashme nëpërmjet impianteve të posaçme të ngritjes me çfaredolloje fuqie si dhe pastrimin e ujërave shkarkues; ndërtim dhe menaxhim i impianteve të pastrimit, dezinfektim i ambienteve, përpunim dhe depozitim për llogari të të tjerëve të produkteve kimike, kërkim dhe zhvillim i produkteve dhe teknologjive të reja lidhur me objektin e shoqërisë.

Subjekti "CHEMICA D'AGOSTINO S.P.A." dshh ushtron aktivitetin e tij në adresën: Rruga "Ura Beshirit", fshati Lalm, Njesia Administrative Vaqarr, Bashkia Tirane.

2 PËRSHKRIM I PROJEKTIT

2.1 Qëllimi i projektit

Qëllimi i funksionimit të këtij aktiviteti është ofrimi i produkteve kimike të nevojshme për tregun vendas. Këto produkte janë të kërkuara nga konsumatori dhe të domosdoshme për mbarefunksionimin e një sere aktivitetesh dhe ofrimin e disa shërbimeve private ose publike. Nder produktet kimike përmendim ato të trajtimit të ujit të pijshëm, të pishinave, etj.

2.2 Të dhëna teknike të aktivitetit

Aktiviteti zhvillohet në dy kapastron konstruksion metalik me panele sandwic, me sistem aspirimi e ndricimi dhe të shtruar me beton. Objekti ndodhet pranë rrugës së fshatit Allgjatë, 200m para urës Beshirit, fshati "Lalm" Komuna Vaqarr, Tirane.

Subjekti, për zhvillimin e aktivitetit të tij është paisur me të gjitha miratimet perkatese të lejeve të nevojshme të funksionimit të aktivitetit nga QKL-ja. Ky aktivitet do të funksionojë në përputhje me


kerkesat e tregut per keto produkte kimike te cilat jane relativisht te rralla per tregun vendas.

Objekti i kapanonit ne dispozicion te ketij aktiviteti ka keto te dhena urbanistike:

Siperfaqe prones dhe sheshit te ndertimit = 2000 m²

Siperfaqe e objekteve per te dyja kapanonet = 1200m²

Planimetria e objektit



Pamje te ambientit



2.3 Vendodhja e objektit

Aktiviteti ne vleresim ndodhet prane fshatit Lalm, te Komunes Vaqarr, Tirane. Kapanoni i propozuar per zhvillimin e aktivitetit, ndodhet buze rruges se fshatit Allgjate dhe ndahet nga rruga Tirane – Ndroq rreth 200 m para “Ures Beshirit”. Orientimi sipas ortofotove te meposhteme:



2.4 Lidhja e objektit me infrastrukturën Inxhinierike

Objekti, eshte i lidhur me te gjithe infrastrukturën inxhinierike te nevojshme. Energjia elektrike dhe furnizimi me uje jane te lidhura, infrastruktura rrugore kalon prane objektit, ndersa telefonia eshte

sherbim privat i pa kufizuar.

Mbetjet e ngurta do te menaxhohen ne bashkepunim me Komunen Vaqarr, nepermjet vendosjes se koshave te mjaftueshem per aktivitetin dhe sherbimi i pastrimit te mbetjeve te ngurta urbane do te kryhet nga firma pastruese e zones, e cila i grumbullon keto mbetje ne Landfillin e Sharres. Mbetjet e riciklueshme, kalojne per riciklim nga subjektet seleksionues te mbetjeve urbane.

2.5 Përshkrimi i proceseve teknologjike të aktivitetit

Proceset qe kryhen ne kete aktivitet jane te thjeshta. Per hollimin e kimikateve te ndryshme sherben nje sasi uji I cili perzihen ne nje sasi te caktuar te kimikatit, kjo ne varesi te sasise perfundimtare qe do te prodhohet dhe perqendrimit te kimikatit.

Procesi I hollimit kryhet ne reaktore te pajisur me perzierjes. Transpoti I kimikatit dhe ujit per ne reactor kryhet nepermjet nje sistemi tubacionesh te pajisura me nje system pompimi per qarkullimin e lendeve te para. Gjithashtu reaktoret jane te pajisur me nje panel kontrolli I cili bene te mundur monitorimin e parametrave te procesit.

Pas procesit te perzierjes dhe hollimit, sipas kerkeses se klientit kryhet ambalazhimi I kimikatit te holluar ne bidona plastik. Ne rast te kundert e gjithe sasia e kerkuar ngarkohet ne cisterna (automjetet te pershtatshme per transport) dhe transportohen ne destinacion sipas kerkeses se klienteve.



2.6 Informacion për shkarkimet në mjedis.

Shkarkimet në mjedis gjatë fazës së funksionimit të këtij aktiviteti do të jenë minimale. Do të jenë kryesisht pluhurat nga lëvizja e automjetit (autobotit) dhe zhurmat teknologjike e ketij te fundit në mjediset e punës. Nga ky aktivitet nuk gjenerohen mbetje të ngurta. Mbetjet e gjeneruara janë vetëm mbetjet nga konsumi i përditshëm i puntorëve. Të gjitha mbetjet e grumbulluara do të dërgohen në

subjektet e licensuara për trajtimin e tyre dhe të asgjësimit të tyre.

3. PERSHKRIM I MJEDISIT TE RAJONIT

3.1. Rajoni i Tiranës

Qyteti i Tiranës shtrihet në një luginë rreth 40 km larg detit dhe në një lartësi mbi 100 metrash. Ka një klimë mesdhetare me verë të ngrohtë dhe të nxehtë e me një sasi reshjesh 1200 mm gjatë dimrave të butë. Temperatura vjetore mesatare është 16°C në muajin më të ftohtë, janarin, me temperaturë 6°C dhe korrikun si periudha më e ngrohtë, me një temperaturë mesatare 24°C. Afërsia e maleve të lartë në lindje të qytetit bën që të dominojnë erërat me drejtim veri-perëndim dhe jug-perëndim.

Bashkia e Tiranës zë një hapësirë prej 41.8 km² dhe është thuajse totalisht e urbanizuar. Rrethi i Tiranës zë një hapësirë prej 1,288 km² dhe përfshin të gjitha komunat përreth Bashkisë së Tiranës, duke u kufizuar me Komunat e Dajtit, Farkës, Vaqarrit, Kasharit, Bërullës dhe Paskuqanit, dhe ndan një kufi të shkurtër me Bashkinë e Kamzës.

Për numrin e popullsisë në 2008, ka vetëm vlerësim dhe ka shumë mundësi të jetë me pak se në realitet, pasi shumë banorë nuk janë të regjistruar në këto zona, por mund të rezultojnë ende si banorë të qyteteve apo fshatrave nga kanë ardhur. Informacioni demografik, në tërësi, është i dobët.

3.2. Mjedisi Fizik

Qyteti i Tiranës zë vend në një rrafshinë midis Lumit Lana dhe Lumit Tirana. Kjo rrafshinë bën pjesë në një rrafshinë më të madhe ku ndodhen Kruja dhe Lezha, ujërat e të cilave rrjedhin drejt veriperëndimit. Mbi rrafshinë ngrihet 1600 metra Mali i Dajtit, i cili dominon horizontin në perëndim të qytetit. Kodrat më të ulëta të Saukut, Kërrabës dhe Vaqarrit, që ngrihen 300 metra, rrethojnë luginën, përkatësisht në perëndim, lindje dhe jug. Kodrat më të ulëta formojnë vargje kodrash deri në bregdetin e Adriatikut me dy korridore nga Durrësi, gjë që lejon me lehtësi komunikimin me bregdetin dhe lejon gjithashtu mbërritjen e rrymave ajrore detare deri në Tiranë.

Me zgjerimin e qytetit, zona midis lumenjve tashmë është urbanizuar plotësisht dhe zhvillimi është shtrirë në kodrat përreth qytetit. Korridori verior drejt bregdetit, i cili lidh Tiranën me Durrësin ka njohur gjithashtu zhvillim të madh me një përzierje veprimtarish komerciale, të industrisë së lehtë e rezidenciale. Bashkia e Tiranës vlerëson se tani zona urbane zë rreth 40 për qind të luginës, ndërsa ekspansioni urban po kap edhe kodrat përreth. Ndërtimet në perëndim, në Malin e Dajtit janë një problem serioz, ku shpyllëzimi dhe urbanizimi, përveç përkeqësimit estetik të zonës, pritet të rrisë nivelin e rrëshqitjeve dhe mund të paraqesë rreziqe serioze përmbajtjeje për qytetin.

3.3. Tendencat Demografike

Gjatë dy dekadave të fundit, Tirana ka qenë një nga qytetet me zhvillim më të shpejtë në Evropë. Me gjithë debatin për shifrat e sakta, popullsia e Rajonit të Tiranës është rritur nga 35,000 në 1989 në afërsisht një milionë sot. Kjo rritje është afërsisht e gjitha nga migracioni i brendshëm në qytet nga të gjithë anët e vendit, pasi njerëzit kërkojnë mundësi më të mira ekonomike. Të gjithë nivelet e qeverisjes në këtë periudhë tranzicioni nuk kanë arritur t'i përgjigjen me burime të përshtatshme kërkesave për shërbime të shkaktuara nga kjo rritje shpejtë e popullsisë.

Kështu, qyteti është rritur përtej zonës së tij të zhvillimit të planifikuar urban. Shërbime të domosdoshme, si furnizimi me ujë e energji, nuk i përgjigjet kërkesave. Menaxhimi i mbeturinave, si të lëngshme dhe të


ngurta, përbën dhe aspektin më të dukshëm të ndotjes mjedisore në Tiranë.

Ka diskutime në lidhje me shifrat e sakta të rritjes së popullsisë në Tiranë. Megjithatë, nga pikëpamja mjedisore (dhe e dhënies së shërbimeve), çështja nuk ka të bëjë me përcaktimin e saktë sasior të rritjes, por me aftësinë për ta menaxhuar këtë rritje. Kapaciteti mjedisor mbajtës i çdo zone është një funksion i kapacitetit të tij të menaxhimit mjedisor.

Qarku i Tiranës kishte një popullsi prej 766 mijë banorësh më 2013 me rritje 26.1 për qind në krahasim me vitin 2001 kur kishte 597 mijë banorë. Rritja mesatare vjetore është 2.1 për qind.

Popullata urbane e Tiranës është rritur nga 380 mijë në 559 mijë banorë, me rritje totale prej 42 për qind dhe rritje mesatare vjetore prej 3.1 për qind. Popullata rurale e Tiranës ka rënë me 1.1 për qind mes viteve 2001 dhe 2013 nga 217 mijë në 213 mijë.

Norma e urbanizimit të Tiranës është rritur nga 64 në 72 për qind. Tirana ka një sipërfaqe prej 1652 kilometrash katrore dhe densitet popullate prej 464 banorë për kilometër katrorë.



3.4. Ekologjia

Edhe urbanizimi i planifikuar dhe i mirë menaxhuar mund të reduktojë ndikimin e florës mbi faunën lokale. Rajoni i Tiranës ka një gamë të gjerë flore dhe faune; ekzistojnë rreth 1600 specie bimësh me përqindje të lartë në raport me sipërfaqen e rajonit. Flora e zonës është e pasur me pemë të tilla si lisi, ahu, pemë halore, si dhe pemë frutore si hurma, kumbulla, shega, mana, kajsia e rrushi e shumë bimë të tjera dekorative.

Përveç shkarjes së tokës, shkatërrimi i pyjeve nuk do të thotë vetëm humbje pemësh, por edhe humbje e diversitetit si pasojë e humbjes së zonave të habitatit dhe të zonave ushqyese.

3.5. Gjeologjia dhe hidrogjeologjia

Tirana shtrihet mbi shtresëzime dhe xhepa kuaternari. Ato janë shtresëzime aluviale përgjatë rrjedhës së dy lumenjve kryesorë. Disa brezare më të vjetra lumore janë të përbëra nga zhavorr, gurë ranor e baltë argjilore.

Tirana shtrihet në një shtresë ujë-mbajtëse me përmbajtje poroze, që është pjesërisht arteziane. Uji i nëndheshëm gjendet kryesisht në pjesën perëndimore të qytetit dhe përdoret si për furnizimin publik me ujë dhe për përdorime private, veçanërisht për industrinë. Puset janë mjaft të cekët, rreth 15 metra të thellë, gjë që i ekspozon ato më shumë ndaj ndotjes nga aktivitetet në sipërfaqe.

Në Tiranë nuk ka aktivitete mineral-nxjerrëse. Ka pasur miniera qymyrguri në Valias, Priskë e Mëzez, të cilat janë mbyllur tashmë. Aktivitetet kryesore nxjerrëse janë ato të marrjes së zhavorrit dhe gurëve për veprimtaritë ndërtuese në shkallë të gjerë në Tiranë. Niveli i nxjerrjes së këtyre materialeve raportohet të ketë ndikuar në grumbullimin e ujërave të nëndheshëm dhe në bllokimin e puseve.

shtratit të lumit. Vëzhgimet tregojnë se 6% e shtëpive në Tiranë kanë nivel të radonit. Ndikimi i radonit, gjithsesi, nuk duket të jetë i dokumentuar në Tiranë.

Monitorimi i cilësisë së ujërave nëntokësore dhe në sipërfaqe supozohet të bëhet nga Departamenti i Higjienës në MMPAU, por vetëm Ndërmarrja e Ujësjetës të Tiranës ka pajisjet për të bërë trajtimin bakterial dhe atë kimik.

3.6. Rreziqet Natyrore

Tirana rrezikohet nga tërmetet. Tërmeti i fundit i madh ka ndodhur në vitin 1988. Zona Tiranë – Durrës shtrihet në një zonë sizmike që ka dy shkarje aktive. Nga 55 tërmetet kryesore të regjistruara në Tiranë në 2000 vitet e shkuara, 36 prej tyre kanë ndodhur në shekullin e 19. Rreth 4-5 tërmete prej 4-5 ballësh të shkallës Richter ndodhin çdo vit në Shqipëri, ndërsa një herë në 25 vite raportohet të ketë ndodhur një tërmet prej 9 ballësh të shkallës Richter.

Me rritjen e urbanizimit dhe degradimit të pyjeve, rreziku i përmbytjeve do të rritet shumë. Kjo gjë përshkruhet më mirë te seksioni mbi Menaxhimin e Mbeturinave të Lëngshme dhe Kullimin e Ujërave të Shiut, më poshtë.

Banka Botërore ka miratuar së fundmi një Projekt të Adaptimit dhe Zvogëlimit të Rrezikut të Katastrofave në Shqipëri. Qëllimi i këtij projekti është të përmirësojë informacionin dhe reagimin për zbutjen e efekteve të çdo katastrofe natyrore. Komponentët përbërës të projektit përmbajnë:

Menaxhimin e Rrezikut të katastrofës;

Forcimin e shërbimeve hidrometeorologjike;

Zhvillimin e kodeve të ndërtimit për aktivitetin sizmik;

Siguracionet për katastrofat për individë dhe biznesin e vogël e të mesëm.

3.7. Mjedisi i Ndërtuar dhe Kultura

Megjithëse Tirana është një qytet relativisht i ri, ka zona të mëdha e godina që mund të caktohen për t'u ruajtur nga shteti. Rreth qytetit, ndodhen edhe disa vendbanime parahistorike. Mbrojtja e tyre është e rëndësishme në kuadrin e këtij zhvillimi të shpejtë që po ndodh. Kohët e fundit, gjatë disa gërmimeve që bëheshin ngjitur me godinën e Bashkisë, janë zbuluar rrënojat e një kështjelle të vjetër. Pjesa më e madhe e godinave historike dhe e godinave me vlerë kulturore gjenden të grupuara rreth Sheshit Skënderbe.

Instituti i Monumenteve të Kulturës, që është nën varësinë e Ministrisë së Kulturës, Trashëgimisë dhe Sporteve, disponon një liste me 100 godina të rëndësishme kulturore që duhen ruajtur. Lista nuk është rishikuar që nga viti 1990 dhe shumë nga këto godina janë shkatërruar ose modifikuar, megjithëse leja për modifikimin e tyre supozohet se duhet të jepet nga Bashkia e Tiranës dhe Instituti i Monumenteve të Kulturës.

Nuk ka fonde të caktuara për ruajtjen e këtyre godinave e nuk duket të ketë as incentiva që kjo gjë të bëhet nga pronarët e tyre.

Shumica e (fondit të) banesave, veçanërisht apartamentet në pallatet pa ashensor, të ndërtuara në vitet 80 me punë “vullnetare”, nuk janë të ndërtuara shumë mirë. Standardet e ndërtimit specifikojnë ndërtime të cilësisë së lartë, por burimet për një përputhje efektive me këto standarde nuk janë në nivelin e kërkuar.

3.8. Aktivitete ekonomike dhe sociale

Ekonomia e Tiranës, si dhe e gjithë Shqipërisë dhe e Evropës Lindore pësoi një shok të fortë gjatë tranzicionit drejt demokracisë dhe ekonomisë së tregut. Shqipëria ndoshta ka vuajtur më shumë se vendet e tjera. Mbyllja e shumë ndërmarrjeve industriale shtetërore dhe mungesa e burimeve financiare solli papunësi të madhe dhe nënkuptonte fonde dhe vëmendje të pakët ndaj përqësimit të kushteve mjedisore.

Për Tiranën, kjo do të thotë mbylljen e shumë prej industrive ndotëse, ndërkohë që të gjitha planet e zhvillimit të qytetit pranojnë idenë e përqendrimit të zhvillimit ekonomik të Tiranës tek aktivitetet tregtare, administrative dhe kulturore, dhe jo në industri sekondare.

Nuk ka ndonjë studim të drejtpërdrejtë që të lidhë kushtet e mjedisit me aktivitetin ekonomik të Tiranës. Megjithatë kushtet mjedisore nuk përbëjnë kriter të rëndësishëm për investitorët potencialë. Furnizimi jo i mirë me ujë dhe energji, në Tiranë mund të kapërcehet lehtësisht nëpërmjet sigurimit të ujit me bote, depozitimit të ujit dhe përdorimit të gjeneratorëve për të prodhuar energji.

Siguria e pamjaftueshme përbën pengesën kryesore për investitorët dhe Shqipëria ka bërë shumë gjatë dekadës së fundit për të përmirësuar situatën e sigurisë në vend.

Kriteret kryesore për investitorët privatë janë: vendndodhja, kosto e tokës dhe krahut të punës; lehtësia e hapjes dhe operimit të biznesit, duke përfshirë këtu marrjen e lejeve dhe legjislacionin për taksat lokale.

3.9. Kushtet gjeografiko-natyrore

Rajoni Perëndimor zë pjesën pranadriatike të Republikës së Shqipërisë nga Hani i Hotit në veri e deri në Vlorë në jug. Në perëndim rajoni laget nga deti Adriatik kurse në lindje kufiri kalon nga rrëza e Alpeve në veri drejt jugut, duke përfshirë edhe sistemet kodrinore të Kerrabes, Dumrese, Mallakastres dhe kodrat e Vlorës në skajin e tij jugor. Brenda këtyre kufijve ky rajon ka shtrirje yeri-jug rreth 200 km dhe lindje-perëndim deri në 50 km. Në drejtim të lindjes, përgjatë luginave të Shkumbinit e të Osumit, rajoni shtrihet deri në Elbasan dhe Berat.

Në Rajonin Perëndimor mbizotëron relievi fushor i cili përbehet nga fusha të mëdha e mjaft pjellore, si për shembull: fusha e Myzeqesë, fusha e Durrësit dhe e Tiranës, fusha e Lezhës dhe e Shkodrës etj. Kurse relievi kodrinor zë sipërfaqe me të vogël dhe përbehet kryesisht nga grumbuj kodrinorë mjaft të copëtuar në lindje (Kërraba, Dumreja, Mallakastra etj.) dhe nga disa vargje kodrinore në brendësi (Rodon Vore-Kërrabe, Divjakë-Ardenice etj.).

I gjithë Rajoni fushor Perëndimor dallohet për klime të ngrohte, ngaqë shtrihet pranë vijës bregdetare. Dimri është i bute dhe me lagështire, kurse vera e nxehte dhe thate. Kjo klime favorizon kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore, por që kanë nevojë për ujë në stinën e thate të verës.

Pasuria ujore është e madhe. Përveç daljes së gjere të rajonit në detin Adriatik, në të kalojnë dhe derdhen lumenjtë me të rëndësishëm të gjithë trevave shqiptare, si: Buna, Drini, Mati, Shkumbini, Semani, Vjosa etj.

Duke rrjedhur në fushat e këtij rajoni, shtrati i këtyre lumenjve është i ceket dhe me mjaft dredhime. Për këto arsye janë te shpeshta vërshimet dhe përmbytje. Gjithashtu, në pasurinë ujore te këtij rajoni përfshihet edhe liqeni i Shkodrës dhe disa liqene te tjera te vogla natyrore e artificiale.

Bimësia natyrore e rajonit është pothuajse e zëvendësuar tërësisht nga ajo e kultivuar, duke e kthyer kështu në rajonin me te rëndësishëm bujqësor te Shqipërisë. Tokat fushore janë tepër pjellore. Ato përbejnë bazën për zhvillimin bujqësor, prandaj sistemimi dhe mirëmbajtja e tyre paraqet rendësi te veçante.

Nga bota shtazore mund te përmendim zogjtë, shpendët dhe kafshët e ndryshme (fazanin, pelikanin, rosat e egra, lepurin etj.), që rriten pranë bregdetit, si në zonën e Lezhës, Divjakës, Nartës etj. Po kështu në pjesët kodrinore te rajonit hasen lloje te ndryshme shpendësh dhe kafshësh te egra. Rajoni, duke pasur sipërfaqe te lumenjtë, bën te mundur që në to te rriten edhe lloje te ndryshme peshqish.

Kushtet gjeografiko-natyrore te para se bashku përbejnë pasuri te mëdha natyrore për zhvillimin ekonomik te këtij rajoni. Kane qene pikërisht këto pasuri te shumta natyrore një nga faktorët kryesore që ka bere që ky rajon te jete sot nder me te zhvilluarit në te gjitha pikëpamjet, në krahasim me te gjitha rajonet e tjera te trevave shqiptare.

Tepër e rëndësishme është ruajtja dhe vënia sa me mire në shfrytëzim e këtyre pasurive nga ana e njeriut. Kjo është detyre e te gjithë brezave. Rajoni Perëndimor i Shqipërisë zë një pozite gjeografike te favorshme duke u shtrire përgjatë gjithë brigjeve detare adriatike te Republikës se Shqipërisë. Është një rajon ku mbizotërojnë fushat, klima e ngrohte, ujerat e shumta dhe tokat pjellore. Këto kane bere që ky te jete sot rajoni me i zhvilluar i Shqipërisë në te gjitha drejtimet

3.10. Klima

I gjithë Rajoni fushor Perendimor dallohet per klime te ngrohte, ngaqe shtrihet prane vijes bregdetare. Dimri eshte i bute dhe me lageshtire, kurse vera e nxehte dhe thate. Kjo klime favorizon kultivimin e kulturave te ndryshme bujgesore, por qe kane nevojte per ujitje ne stinen e thate te veres.

Pasuria ujore eshte e madhe. Peverc daljes se gjere te rajonit ne detin Adriatik, ne te kalojne dhe derdhen lumenjtesi Shkumbini dhe Semani. Duke rrjedhur ne fushat e ketij, rajoni shtrati i ketyre lumenjve eshte i ceket dhe me mjaft dredhime. Per keto arsye jane te shpeshta vershimet dhe perrmbytjet.

Tokat fushore jane teper pjellore. Ato perbejne bazen per zhvillimin bujqesor, prandaj sistemimi dhe mirembajtja e tyre paraqet rendesi te vecante.

3.11. Sizmiciteti

Trualli Shqiptar vendoset gjate kufirit te perplasjes se dy pllakave te medha qe levizin njera kunder tjetres; pllakes Euroaziatike dhe asaj Arabo-afrikane, dhe eshte vater e perqendruar termetesh e cila preket me shpesh nga termete demtues.

Tirana si shume zona te tjera te vendit eshte zone e prekur nga termetet, ku nga pikepamja sizmoteknike zona mund te goditet nga termete me magnitute $M_{max}=5.5-6.0$ grade Richter me intensitet deri ne 7 balle MKS-64 e cila shkakton çarje ne mur dhe rrezim te copave te suvash por per objektet e uleta nuk parashikohen shqetesime. Si dhe mundesite per te goditur termetet me shume balle jane te vogla rreth 20%.

3.12. Gjeologjia dhe Dherat

Shqiperia si formacion gjeologjik eshte pjese perberese e rrudhosjeve alpino-mesdhetare pjese e degezimit

Dinaro-albano-Helenid, ku ne bejme pjese tek Albanidet. Tirana si zone e jashtme ben pjese ne Ultesiren paramalore, dhe ndodhet ne krahinen e ultesires perendimore, dhe karakterizohet nga shkembinj te dobet qe i ben te paqendrueshem nga rreshqitja dhe eshte pjese e sistemit neogjenik argjila, konglomerat ranor. Zona karakterizohet nga brezi i tokes se hirte kafe, ku ajo vendoset mbi formacione sedimentare dhe sasia e humusit eshte e vogel rreth 2-4%. Ne sheshin e ndertimit marrin pjese formacione te neogjenit te perfaqesuara nga nderthurje alevrolitesh argjilore e ranore si dhe nga depozita aluvilo-deluviale te kuarternit, trashesia e te cilit arrin deri ne 25-30 m.

3.13. Hidrologjia, ujrart siperfaqesore dhe nentokesore

Ne kete rajon takohen ujerat nentokesor ne depozitat zhavorr. Niveli i ujit nentokesor eshte 3.80m nga siperfaqja e tokes por ne puset e shpimit ai arrin te ngrihet dhe te stabilizohet ne 0.6-0.8 m thellesi dhe ne varesi te stines niveli i tyre ndryshon. Pasqyra e nivelit te perhershem te ujerave nentokesor luhaten sipas rreshjeve.

Ne zonen ku ushtrohet aktiviteti verehet se nuk ka burime siperfaqesore ne distanca te aferta. Ne zonen e shfrytezimit dhe perreth saj nuk ka zona te lundrueshme dhe nuk ndodhen liqene dhe dete, prandaj gjate shfrytezimit nuk do te cenohen rruget ujore, brigjet bregdetare etj. Ne konturin anesor te zones dhe ne pjesen lindore te prones ne studim vihen re ish kanalet e drenazhimit qe kane ekzistuar per keto toka bujqesore.

3.14. Mjedisi biologjik

Vegjetacioni qe takohet ne kete zone fushore eshte tipik i mjediseve te ulta, anash rrjedhjeve ujore-kanaleve kullues te tokave bujqesore. Ne zonen ne studim duke qene se jane perdorur per qellime bujqesore nga kooperativat para viteve '90 bimesia e zones ka qene e llojit te drithrave dhe pas lenies se saj djerre aty ka mbizoteruar bimesia barishtore dhe ne disa vende bimesi shkurre.

Zona me rendesi te vecante:

Territori ne studim nuk eshte i perfshire ne zone te mbrojtur si:

- a) rezerve strikte natyrore\ rezervat shkencor\ (kategoria I);
- b) park kombetar (Kategoria II);
- c) monument natyror (Kategoria III);
- d) rezervat natyror i menaxhuar\ zone e menaxhimit te habitateve dhe llojeve (Kategoria(IV));
- e) peizazh i mbrojtur (Kategoria V);
- f) zone e mbrojtur e burimeve te menaxhuara\ zone e mbrojtur me perdorim te shumefishte (Kat VI).

Territori ne studim nuk eshte i perfshire ne zone buferike, te cilat ruhen ne perputhje me legjislacionin perkates ne fuqi. Zona ne studim nuk bene pjese ne zonat e mbrojtura me interes nderkombetar apo te cenoi ndonje nga konventat e nenshkruara.

3.15. Te dhena per Komunen Vaqarr

Komuna vaqarr eshte nje prej Komunave te Rajonit te Tiranës, ajo pozicionohet ne zonen jugperendimore te qytetit te Tiranës dhe ndodhet rreth 7km ne vije ajrore larg nga qendra e qytetit e Tiranës (Sheshi Skenderbej). Komuna Vaqarr perfshin 10 fshatra: Vaqarr, Allgjate, Arbane, Bultice, Damjan-Fortuz, Gropaj, Lalm, Prush, Vishaj, Sharre.

Komuna Vaqarr se fundmi ka hartuar dhe miratuar Planin e Pergjithshem Vendor PPV per te gjithë territorin administrativ te kesaj komune dhe zhvillimet e reja ne kete zone kryhen ne perputhje me Planin e Pergjithshem Vendor.

Me poshte paraqitet nje pamje satelitore e pozicionimit te Komunes Vaqarr ne lidhje me Tiranen.

